



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Nr.530Prot.

Tiranë, më 10.10.2017

**KERKESË PËR VLERSUËS**

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, në kuadër të vlerësimit të moduleve të programeve të trajnimit të paraqitura nga Agjencitë Trajnuese për akreditim, shpall kërkesën për vlerësues.

Në mbështetje të nenit nr.21, të udhëzimit të MASR nr.1 datë 20.01.2017 'Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë', pranohen si vlerësues:

- a) Mësuesi që është vlerësuar me 'shkëlqyeshëm' ose 'shumë mirë', në provimin e fundit të kualifikimit.
- b) Drejtori, institucioni arsimor i të cilit është vlerësuar me të paktën 'Mirë' nga Inspektorati Kombëtar i Arsimit brenda katër viteve të fundit shkollore ose shkolla që drejton, është përfshirë ndër shkollat e suksesshme në një vend nga dy vitet e fundit shkollore.

Kandidati për vlerësues është mësues ose specialist që zotëron njohuri të mjaftueshme për modulin, të dëshmuara në CV-në e tij.

Kandidatët e interesuar si vlerësues duhet të dorëzojnë CV-në e tyre, pranë Institutit të Zhvillimit të Arsimit, deri në datë 25.10.2017 ora 16.00.

***Faleminderit.***